



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 17, 18 19, 20, 21, 22 dhe nenit 92 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.207 si dhe vendimit të miratuar nga Kuvendi 01 Nr. 179/21 të dt. 29.03.2021, Zyra e kryesuesit të Kuvendit Komunal në bashkëpunim me Zyrën për Informim lëshon këtë:

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 4/185 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1

Data/Datum/Date 13.04.2021

NJOFTIM PUBLIK

LIDHUR ME DISKUTIMIN PUBLIK PËR DRAFT RREGULLOREN KOMUNALE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VITË TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

Draft rregullores komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale do të jetë në shqyrtim publik nga data **13.04.2021** deri me datë: **13.05.2021**.

Duke u bazuar në gjendjen e krijuar nga virusi pandemik COVID-19 dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës: **05.04.2021 me Nr 01/05**, për masat e përgjithshme dhe të veqanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, **diskutimi publik me qytetarët dhe palët e interesuara** nuk do të mbahet, por të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo komentet mund të dërgohen në formë elektronike në këto E-maila: Skender.Hamza@rks-gov.net, Haziz.Krasniqi@rks-gov.net dhe sarandasallteku@rks-gov.net deri me datë: **12.05.2021**.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth kësaj draft rregulloreje, Komuna e Rahovecit, konkretisht Zyra e kryesuesit të Kuvendit Komunal në bashkëpunim me Zyrën për Informim, ka publikuar këtë propozim dokument në ueb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit : <https://kk.rks-gov.net/rahovec/> në rubrikën "Dokumente në Konsultim Publik": <https://kk.rks-gov.net/rahovec/rahovec-4/dokumentet-ne-konsultim-publik/>.

I mirëpresim komentet tuaj!



Udhëheqës për Punë të Kuvendit

Skender Hamza